Këshilli i Mediave të Shkruara të Kosovës
Press Council of Kosovo
Savet Štampe Kosova

13.10.2020, Prishtinë,
Ref:26.06.2020\1020-2020

Vendim i Këshillit të Mediave të Shkruara të Kosovës ndaj ankesës së Hasan Lushi, i përfaqësuar nga Kërveshi & Partners firmë avokatije kundër Gazeta Botapress.info

Këshilli i Mediave të Shkruara të Kosovës në mbledhjen e tij të mbajtur më 30 shtator 2020, shqyrtoi ankesën e Hasan Lushit, i përfaqësuar nga Kërveshi & Partners firmë avokatije kundër Gazeta Botapress.info lidhur me publikimin e artikullit me titull: "Kjo është shtëpia luksoze e biznesmenit nga Juniku që ju sekuestrua pasuria milionëshet", dhe mori këtë:

V E N D I M

- Ankesa nuk miratohet.

A R S Y E T I M I

Ankuesi pretendon që media ka publikuar artikullin me titull "Kjo është shtëpia luksoze e biznesmenit nga Juniku që ju sekuestrua pasuria milionëshe", i cili sipas ankuesit është në kundërshtim Kreun VII (Privatësia) e Kodit të mediave të shkruara.

Lajmi është shkruar në media online dhe objekt i kësaj ankese është teksti i shkruar, e që rrjedhimisht ankesa është e lejueshme për trajtim dhe e afatshme.

Pas leximit të artikullit dhe shqyrtimit të ankesës, KMShK gjen se ankesa është e pabazuar.

Ankuesi ka të drejtën e plotë të paraqesë ankesë nën pretendimin se i është shkelur privatësia e tij kur janë publikuar fotografitë e shtëpisë së tij, dhe fotografitë e ankuesit. Sipas tij ky është gjurmim në jetën e tij private, edhe se interesi i publikut për të nuk ekziston.

KMShK ka trajtuar ankesën dhe ka gjetur se ankesa është në tërësi e pabazuar, fillimisht për faktin se fotografitë e ankuesit janë publike në rrjetin social Facebook dhe nga kushdo mund të qasen e të shihen. Poashtu është shumë e rëndësishme për publikun të dihet se një aktor i një seriali që transmetohet në televizionin publik të Kosovës RTK është i akuzuar nga prokuroria e Zvicrës dhe të njëjtit i janë sekuestruar disa prona në Republikën e Shqipërisë.

Fakti që një serial paguhet nga taksat e qytetarëve dhe në të luan ankuesi, është dëshmi e mjaftueshme për interesin publik. Nuk mund të konsiderohet gjurmim në jetën private publikimi i fotografive të shtëpisë së ankuesit pasi ato janë publike në faqen e tij të Facebook dhe mund të qasen nga kushdo edhe pa llogari të FaceBook-ut.

KMShK vendosi si në dispozitivin e këtij vendimi.

Këshilli i Mediave të Shkruara të Kosovës